

PRIRJE GLOBALIZUESE TË SHQIPES**Irda DERVISHI NESIMI***Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Gjuhësisë
irdadervishi@yahoo.com***Abstrakt**

Kërkesat e shoqërisë së sotme shqiptare e vendosin përdoruesin e gjuhës shqipe në situata të ndryshme falë nevojës për pjesëmarrje aktive në hapësirën globale, brenda arealit shqipfolës e përtej tij në diasporë ku ka folës të emigruar. Rrjedhimisht, ai është i ndikuar nga një fjalës i huaj social e tekniko-shkencor, që e ndihmon më tepër në zhvillimin e komunikimit me pjesëtarët e kësaj shoqërie. Kjo dukuri nuk është e re edhe për gjuhë të tjera. Si çdo gjuhë edhe shqipja në kohë të ndryshme ka huazuar fjalë të huaja.

Objekti i këtij punimi është të pasqyrojë të praninë e fjalëve të huaja në leksikon shqipes të vështuara periodikisht në “Fjalorin e Gjuhës shqipe” (Tiranë, 2020, 782 f.) dhe në “Fjalorin e Gjuhës shqipe” (Tiranë, 2006, 1250 f.). Punimi synon që të paraqesë prirjen që ka gjuha shqipe ndaj përfshirjes së fjalëve të huaja në fondin e saj leksikor për shkak të ndërveprimeve globale.

Qëllimi i punimit është përfaqësimi i një fondi (jo shterues) fjalësh të huaja në përdorim, të marra nga burime të ndryshme si dhe të trajtojë problematikat që ato shpërfaqin në drejtshkrim dhe në drejtshqiptim. Njëkohësisht, në vijim do të shqyrtohet edhe roli i tyre në pasurimin apo varfërimin e gjuhës shqipe.

Nga ana tjetër, punimi parashtron disa probleme që lindin nga përdorimi i gabuar i fjalëve të huaja në kontekste të caktuara gjuhësore dhe sociale, duke dhënë dhe disa propozime për mënjanimin e tyre.

Fjalë kyçe: fjalë e huaj, fjalorë, globalizëm, gjuhë shqipe, leksik.

Hyrje

Përpyekjet për një gjuhë shqipe standarde të përbashkët me tërësinë e parimeve shkencore dhe historike, nisën që në periudhën e Rilindjes Kombëtare, kur rilindësit u përpoqën shumë që shqipja të kishte një shtrirje më të gjerë të përdoruesit duke nxitur njëkohësisht mënjanimin e fjalëve të huaja dhe zëvendësimin e tyre me fjalë autoktone të shqipes. Dihet se pozita gjeografike, kushtet socio-politike dhe zhvillimi ekonomik i vendit tonë, kanë bërë që përdoruesi i gjuhës, të jetë i ndikuar nga një fjalës i huaj social e tekniko-shkencor, që e ndihmon atë në zhvillimin e komunikimit me pjesëtarët e kësaj shoqërie. Por kjo dukuri nuk është e re edhe për gjuhë të tjera. Si çdo gjuhë edhe shqipja në kohë të ndryshme ka huazuar fjalë të huaja, duke pasur burim kryesor të huazimeve të hershme latinishten, greqishten, sllavishten dhe turqishten.

Politika gjuhësore, përkrahëse e idesë së pastrimit dhe pasurimit të shqipes, vijoi edhe pas Çlirimit. Në gjuhën shqipe vërehen disa huazime më të reja që i përkasin gjuhëve neolatine, të cilat vijnë në kontekstin e ndikimit të frëngjishtes, italishtes dhe më pak të anglishtes në shek. XIX-XX. Për këtë çështje kemi qëndrime të ndryshme të studiuesve si A. Kostallari (2016:352-354), i cili për anglicizmat, thotë se “Depërtimi i gjerë i pandërprerë i tyre në gjuhët e ndryshme të Evropës, ka krijuar vështirësi e probleme në këto gjuhë dhe ka ngjallur shqetësime të ligjshme të gjithë ata që përpiqen për të mbrojtur e lulëzuar gjuhët amtare.” Më tej ai shprehet se “Qëndresa e gjuhës sonë letrare të njësuar ndaj kësaj trysnie është tepër e fuqishme, më sistimore dhe më e vetëdijshme sesa ajo e ish-varianteve letrare të mëparshme. ... të gjitha këto

u kanë dhënë një shtysë të re përpjekjeve të sotme për të pastruar gjuhën letrare nga fjalët e ndërtimet e huaja të panevojshme dhe për të gjurmuar fjalën dhe shprehjen shqipe në gjirin e popullit”. Ndërsa J. Thomai (2017:259), pranon rëndësinë dhe rolin e fjalëve të huaja e të huazimeve në një gjuhë. “Pavarësisht nga shkaqet dhe nga statusi i huazimeve leksikore, të pranueshme a të kritikueshme, ato kanë pasur edhe një vlerë, kanë pasuruar e kanë gjallëruar ligjërimin, kurse në disa fusha (si terma) vlera e tyre shënuese ka dalë në plan të parë.” Mund të themi se faktorët jashtëgjuhësorë, sidomos ato politiko-shoqërorë janë ndikime të fuqishme sa i takon depërtimit të fjalëve të huaja në një gjuhë. Por kur gjuha ka një sistem të qëndrueshëm të strukturave leksikore, gramatikore, sintaksore apo fjalëformuese, ajo i ka të gjitha mundësitë e zhvillimit të saj, duke iu larguar “rrezikut” që i vjen nga ndikimi i tyre

Metodologjia

Objekti i këtij punimi është studimi i fjalëve të huaja në leksikun e gjuhës shqipe. Pas një qëmtimi të materialeve gjuhësore të marra nga burime të ndryshme, janë evidentuar fjalët e huaja, të cilat më tej janë përqsaur me “*Fjalorin e Gjuhës shqipe*” (Tiranë, 2020, 782 f.) dhe me “*Fjalorin e Gjuhës shqipe*” (Tiranë, 2006, 1250 f.).

Ky fond (jo shterues) i fjalëve të huaja është studiuar edhe nga këndvështrimi i drejtshkrimit dhe i përshtatjes me rregullat fonetiko-morfologjike si dhe leksiko-semantike të gjuhës shqipe. Sakaq janë veçuar trajtat drejtshkrimore të gjuhës prej së cilës kanë hyrë në gjuhën shqipe.

Mendojmë se përqsaja e këtij fondi leksikor fjalësh na jep një informacion më të qartë për praninë e tyre në këta Fjalorë, duke propozuar edhe përdorimin ose mospërdorimin e tyre, në rastet kur gjendet gjegjësjë në gjuhën shqipe. Sigurisht merren në konsideratë ato fjalë të huaja të cilat vështrohen si të nevojshme në leksikun e shqipes.

Prania e fjalësit me burim të huaj në gjuhën shqipe, e vështuar periodikisht në Fjalorët shpjegues të saj, është një tregues i prirjes që këta Fjalorë kanë ndaj përfshirjes së tyre.

1. Prania e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe

Vitet e fundit vërehet një rritje e pranisë së fjalëve të huaja, kryesisht në publicistikë dhe më pak në letërsinë artistike. Në depërtimin dhe zgjerimin e përdorimit të tyre kanë ndikuar edhe shkrimet, ligjërimet, fjalimet e politikanëve, përfaqësuesve të pushtetit apo zyrtarëve, sikurse edhe rrjetet sociale, media si radio-televizioni, revistat, media online etj. Si rrjedhojë është shfaqur shqetësimi për një kërcënim që asaj po i vjen nga këto ndikime, shqetësim i cili vjen nga disa studiues, gjuhëtarë, analistë dhe të tjerë që tregojnë përkujdesje për përdorimin e drejtë të shqipes. Por a kemi të drejtë të shqetësohemi për këtë dukuri? Sipas Rrokaj (2009:75), “...folësit fillojnë e reagojnë me vetëdijen e vetëmbrojtjes, shtien në punë kujtesën e përbashkët për të kërkuar brenda gjuhës që përdorin gjegjëset e tyre dhe, vetëm kur bëhet i pamundur zëvendësimi, atëherë pranojnë t’i përdorin duke ua nënshtruar sistemit të gjuhës së tyre. Sa më i plotë të jetë standardi i një gjuhe nga pikëpamja e gjithëpërfshirjes gjuhësore anekand dhe masës së folësve që e përdorin atë më shumë rritet qëndresa ndaj trysnisë së huazimeve.”

Vlen të theksohet se pastërti e gjuhës nuk do të thotë domosdoshmërisht mënjanim i fjalëve të huaja. Nëse gjuha ka nevojë për fjalë që shenjojnë një koncept, send etj, të cilat ajo nuk i zotëron, më e udhës është huazimi sesa mënjanimi i tyre, si në shembujt: *hamburger*, *futnotë*,

katering, koktej, obez, roming, producent etj. Ndërsa kur fjala e huaj ka hyrë në gjuhën shqipe edhe pse ajo e ka gjegjësen e saj, në këtë rast ajo mund të konsiderohet e panevojshme, si p.sh.: *abuzoj* – keqpërdor, *afishoj* – shpall, *alokoj* – caktoj, *adaptoj* – përshtas, *akceptoj* – pranoj, *dislokoj* – zhvendos, *event* – ngjarje, *fenomen* – dukuri, *evidente* – e qartë, *fokusoj* – përqendroj, *fokus* – qendër, *implementim* – zbatim, *independent* – i pavarur, *suportoj* – mbështes etj. Sakaq folësi i gjuhës shqipe është i informuar se për disa fjalë të huaja në leksikun e gjuhës shqipe është një fjalë shqipe gjegjëse me të.

Depërtimi i fjalëve të huaja, në leksikun e gjuhës shqipe në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ka qenë i pashmangshëm në kohë të ndryshme. Vlen të përmendet se edhe shenjimi i nocioneve të reja çon në krijimin e fjalëve të reja, njëkohësisht edhe në huazimin e fjalëve të huaja. A mund të jenë puristë studentët, nxënësit, emigrantët shqiptarë, të cilët ndeshen çdo ditë me anglicizma, italianizma, që bëhen pjesë e fondit të tyre leksikor? Mund të themi se përdorimi i tyre vjen si kërkesë e shoqërisë së sotme që e vendos përdoruesin e gjuhës shqipe në situata të ndryshme, si një nevojë për një pjesëmarrje aktive në hapësirën globale, brenda arealit shqipfolës dhe përtej tij në diasporë ku ka folës të emigruar.

Lehtësia në komunikim ndërmjet kombeve krijohet edhe nëpërmjet mësimi të gjuhës së huaj, por kjo nuk do të thotë se fjalët e huaja duhen pranuar për këtë arsye. Shpeshherë mund të ndodhin edhe keqkuptime nga mosnjohja e kuptimeve të tyre, të cilat mund të çojnë edhe në lindjen e situatave gjuhësore dhe shoqërore, jo fort të këndshme, ndonjëherë edhe qesharake.

Shpeshherë, të flasësh apo të shkruash duke përdorur fjalë të huaja, në ditët e sotme vërehet si një shenjë modernizmi dhe për t'u bërë pjesë e një kësaj prirjeje moderniste, është bërë e udhës që në ligjërimin publik ose në ligjërimi të tjera të përfshihen fjalë të huaja. Por Fishman (1983:107-118) shprehet se modernizmi kërkon një amalgamë të së resë me të vjetrën, përmasat dhe interpretimet e secilës duhet të ripërshtaten vazhdimisht. Modernizmi nuk duhet të vijë si një kërkesë e shtresave elitare, por si një nevojë për një vazhdimësi socio-kulturore, stabilitet dhe legjitimitet, pavarësisht se sa ndryshime teknike-ekonomike ndodhin. Përdoruesit e gjuhës të vendosur në kontekste të caktuara socio-kulturore dhe në kushte historike të imponuara, shfaqin një tërheqje kah fjalëve të huaja. Përgjithësisht nuk është e mjaftueshme vetëm qenësia e tyre në këto kushte e situata, por çdo herë e më tepër po vërejmë që më shumë se sa një nevojë, fjala e huaj ka hyrë në përdorim si një shenjë treguese e një prestigji në shoqëri. Kështu ajo shtresë e shoqërisë që është më e arsimuar e që gëzon një vetëdije më të lartë gjuhësore, priret drejt zotërimit të fjalëve të huaja të panevojshme. A. J. Meier, shprehet se përdorimi i fjalëve të huaja nuk është vetëm çështje prestigji apo nevoje. Ai përkrah idenë se ndonjëherë fjala fiton më shumë fuqi shprehëse në përputhje me nevojën dhe prestigjin (A. J. Meier 2000:169). Kësisoj leksiku është një prej nënsistemeve të gjuhës më i prekur ndaj ndikimeve të huaja.

2. Drejtshkrimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe

Për një kohë të gjatë shqipja po “jeton” si një gjuhë e hapur ndaj ndikimeve të reja në periudhën e një globalizmi që ka përfshirë disa sfera të jetës. Për Xh. Lloshin (2022:51), nuk përbëjnë më një shqetësim huazimet e hershme, por shqetësimi i tij, me të drejtë, është i përqendruar mbi parimin fonetik të shkrimit të disa fjalëve të huaja që kanë hyrë në shqipe. Ai përdor termin ‘citime’ për ato fjalë të huaja që kanë depërtuar në gjuhën tonë dhe që shkruhen në të njëjtën

trajhtë fonetike sikur gjuha burimore. Të tilla janë fjalët: *online, live, party, chat, tost, love story, non-stop, VIP, PC, hit* etj.

Duke paraqitur edhe formulimet përkatëse për huazimet dhe citimet, Lloshi (2022:52-53), thekson se “Huazimet janë fjalë ose togfjalësja nga një gjuhë e huaj, që përdoren në tekste gojore e të shkruara të shqipes, duke iu nënshtruar sistemit të saj. Citimet janë fjalë ose togfjalësja të një gjuhe të huaj, që përdoren në tekste gojore ose të shkruara të shqipes, por pa iu nënshtruar fonetikës, drejtshkrimit, gramatikës dhe rregullave të ndërtimit të teksteve shqipe. Këto janë mirëfilli njësi të huaja në shqipen, nuk janë huazime.” Kësisoj vërejmë shumë fjalë që ndryshe shkruhen dhe ndryshe shqiptohen si: *airbag/eirbeg, full-time/fulltjajm; part-time/partajm; single/singëll; empty/empti; recycle bin/risajkëll bin; free/fri; duty free/djuti fri; look/luk; first class/fërst klas; fifty-fifty/fifti fifti; copy/kopi; no comment/no koment* etj.

Nga ana tjetër vërejmë disa shembuj ku fjalët e huaja janë përshtatur me strukturën fonetike dhe gramatikore të shqipes: *bum, bajpas, boks, buxhet, disenjë, disenjoj, fejsbuk, fastfud, futboll, hokej, imazh, klik, klikoj, kliring, klub, kopirajt, kurrikul, maus, mikrobush, nokaut, paund, penicilinë, performancë* etj. Përballë mëdyshjes se si duhet të shkruhet e shqiptohet fjala e cila emërton monedhën e përbashkët evropiane *euro* apo *evro*, u gjendën edhe vendet që u prekën nga vendosja e qarkullimit të kësaj monedhe. Kësisoj fjala e huaj hyn në një gjuhë kur ajo ka një hapësirë leksikore, e cila nuk përmbush nevojat e përdoruesit duke pasur trajtat drejtshkrimore a drejtshqiptimore të gjuhës burimore si dhe të gjuhës pjesë e së cilës është bërë.

3. Përqasja e fjalëve të huaja me Fjalorët shpjegues të shqipes

Në këtë punim janë përqasur disa fjalë të huaja të cilat janë pjesë e burimeve të ndryshme me “*Fjalorin e Gjuhës shqipe*” (Tiranë, 2020) dhe me “*Fjalorin e Gjuhës shqipe*” (Tiranë, 2006). Marrja në shqyrtim e këtyre Fjalorëve hedh dritë edhe në trajtimin e dukurisë së globalizmit që prek gjuhën shqipe. Rezulton se qëllimi i përfshirjes së fjalësit të huaj në këta Fjalorë është krijimi i përdorimeve të larme të së njëjtës fjalë. Kështu në fondin e fjalëve të huaja të marra në shqyrtim, u vu re se disa prej tyre kanë pranë edhe variantin sinonimik si p.sh.: *avancoj, përparoj; event, ngjarje; fajl, skedar; fastfud, gatim i çastit; lajv, drejtpërdrejt; leadership, udhëheqja e lartë, okej, miratim, pranim; onlajn, në linjë; riskoj, rrezikoj; startoj, filloj; sekondar, dytësor; shou, shfaqje artistike e gëzueshme; transparencë, tejdukshmëri, qartësi* etj. Nga ana tjetër vërehen disa fjalë të cilat kanë hyrë në përdorim me të njëjtën trajtë drejtshkrimore si të anglishtes, p.sh.: *thriller, syllabus, pasëord, server, shopping, target, exchange, popcorn, bestseller* etj., një dukuri e ngjashme kjo edhe në gjuhë të tjera të Europës si në Itali, Francë etj.

Duke njohur rolin e rëndësishëm të Fjalorëve për kodifikimin e gjuhës, J. Thomai (2017:288) pohon se “Fjalorët si vepra kodifikuese, na e japin gjendjen e leksikut deri në çastin e hartimit të tyre, por zhvillimin e lëvizjet në leksik më shpejt e pa ndërprerje i shohim në ligjërimin e gjallë, të folur e të shkruar, natyrisht në rrafshin e standardit, pra normativ.” Fjalorët shpjegues janë një dokumentim i fjalës për nga ana fonetike, gramatikore, semantike si edhe stilistike. Po ashtu ata na japin edhe një gjendje të pasurimit të leksikut deri në çastin e hartimit të tyre, por në të njëjtën kohë janë edhe një vepra urdhëruese sa i takon respektimit të normës gjuhësore. Korpusi i fjalëve të huaja është klasifikuar sipas pranisë së tyre në Fjalorët shpjegues të marrë në shqyrtim në bazë të karakteristikave të tyre si më poshtë :

- Disa fjalë apo terma të huaj që u janë përshtatur rregullave fonetiko-morfologjike të shqipes dhe që janë të pranishëm në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, 2020 si: *abonoj, abstrakt, adaptoj, adoptoj, aerobi, aifon (angl.), akses, antibiotik, antivirus, apdetoj (angl.), aplikoj, aprovoj, aset, asistoj, audit, avancë, avancoj, bajpas, bajt, basketboll, bekgraund, bejsboll, biftek, bilanc, biznesmen, blic, blof (bluff), blofoj, bluz, badigard, bojkotim, bojkotoj, boks, boksier, bold, bord, bos, buding, buldozer, bum, bumerang, bunker, buxhet, çast, çek, celular, cent, çip, darvinizëm, debat, dekoder, disenjë, desktop, disk, disketë, dividend, dollar, donator, draft, drogë, drogim, drogohem, editor, ekskavator, eksport, event, fajl, fastfud, fejsbuk (facebook), fermë, fermer, finale, flesh, (usb), flirtoj, foks, (muz.), fokstrot, (muz.), folklor, fond, formal, futboll, gol, golf, gril, handikap, hokej, honorar, huligan, imazh /imixh, i-meil/imeil, impakt, impakt, implementim, import, informal, internet, intervistë, izotop, jaht, jard, kameraman, kamping, kampion, kangur, karakter, kartel, keçap, kek, kesh, kilovat, klikoj, kliring, klonim, klonoj, kloun, klub, kolaps, kopirajt, kompaktdisk, kompjuter, kompjuterizoj, koncern, kongresmen, konsensus, korporatë, kros, kultivar, kurrikul, kursor, lajv/live, landfil, laptop, liberal, lider, lidship, listim, listoj, lob, lobing, loboj, marketing, master, maus, menaxher, menaxhim, menaxhoj, mikrobus, miting, mocion, modem, moderator, monitor, monitoroj, monitorim, najlon, nokaut, okej, onlajn, operator, operoj, parking, parlament, partner, pas, (sport.) pasim, (sport.), paund, penallti, penicilinë, performancë, piknik, poster, primare, printer, printim, printoj, pulovër, radar, raketë, ramstek, raund, rekord, rekordmen, relaks, relaksohem, resurs, ring, risk, riskoj, roker, rul, rum, rural, samit, sekondare, sanduiç, sërf, servis, sesion, sherif, shok, (mjek.), shokim, shokoj, shou, skaner, skanoj, snajper, spiker, sponsor, sponsorizoj, sprinter, staf, sterlinë, stok, stop, stres, tablet, tank, tenis, terminal, test, top, trafik (droge), trajner, trajnim, trajnoj, tramvaj, transfer, transparencë, trend, trolejbus, truk, turist, uiski, uotsap (whatsapp), vagon, vat, vaterpolo, videoklip, vinç, volejboll, xhaul, xhaz, xhinse, xhungël.*

- Fjalë të huaja të cilat janë të pranishme në disa fusha të shkencës apo aktiviteteve shoqërore, por nuk bëjnë pjesë në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, 2006, 2020. Këto fjalë janë të pasqyruara në trajtat drejtshkrimre ashtu siç janë gjetur në burimet e shfrytëzuara në këtë punim, të tilla si: *abdejt看, abdejt看, absenteizëm, agreement, airbag, ajsberg, alokim, alokoj, antifrizë, apartejd, aut, output, bachelor/baçelor, baj-baj, banking, bebisiter, behaviorizëm, bestseller, big ben/ big bang, bikini, bipartizan, bit, biter, black out/bllekaut, blu tuth, bodibilder, bodibilding, broker, CD, change, çek-in, coca-cola, cornflakes, CV, çat (chatt), çatoj (chatten), daunalaudoj, dedlajn, derbi, destroyer, dilit, displej, djuti-fri, drajver, dribling/driblim, dribloj, dumping, empti, ence, error, establishment, exchange, fair play, faks, fans, farmerka, faull, fërst klas, fërst-ledi, fifti-fifti, fikshën , finish, fitnes, fizibilitet, flash, fri/free, fri-shop, fulltajm, futnotë, golaverazh, grant, hamburger, happy end, harddisk, harduer, hiperlink, hit, hitparejd (hitparade), holl, hollding, homepage hot dog, inç, input, involvim, involvohem, italik, kancel, kanion, kat/cut, katering, kauboj, killer, knokaut, koktej, kompatibël/ inkompatibël, kontejner, konvertibilite, kopi(copy), korne(r), kriket, krosim, krosoj, laburist, layout, lazer, lift, linçim; linçoj, link, look/luk, lord; love story, mailbox, marins, mass-media, mikser, mjuzikëll, network, news, no comment, nokdaun, non-stop, nuklear, obez, obezitet, off, offline, offset, ofsajt, on, opsion, overdozë, panel, pankinë, partajm, party, pasuord, PC (personalkompjuter), pejs/paste, pepsi, pikap(pick-up), pik-u, pitstop, play off, plejbak (playback), plejboj, poker, polpozishën, popcorn, procesor, producent, promocion,*

promocional, provajder, pub/pab, rafishtatë, rekreacion, rekreativ, rent-a-car, reporter, risajkëll bin/ recycle bin, rokenroll, roming, sajt, seju/save, serial killer, server, setap, shampo, shop, shopping, showman, shuter, singëll, skeç, sleng, slogan, SMS, soft, spelling, spot, star, steitment, stopoj, streçe-t, syllabus, target, task force, telefaks, thriller, toner, top model(e), top model, top secret, top shou, tost, trajler, trajning, transaksion, trendi/trendy, trolej, T-shirt, uikend, unisex, VIP, xhekpote, xhentelmen, zum (zoom).

- Fjalë apo terma të huaj që u janë përshtatur rregullave morfo-sintaksore e drejtshkrimore të shqipes dhe që janë të pranishëm në Fjalorin e Gjuhës Shqipe 2006, 2020, si: *abonoj, abstrakt, adaptoj, adoptoj, aerobi, antibiotik, aprovoj, asistoj, avancë, avancoj, basketboll, biftek, bilanc, biznesmen, blic, blof (bluff), blofoj, bluz, bojkotim, bojkotoj, boks, boksier, bord, bos, buding, buldozer, bum, bumerang, bunker, buxhet, çast, çek, celular, cent, çip, darvinizëm, debat, disenjë, disk, disketë, dividend, dollar, donator, drogë, drogim, drogohem, ekskavator, eksport, fermë, fermer, finale, flirtoj, foks, (muz.), fokstrot, (muz.), folklor, fond, formal, futboll, gol, golf, gril, hokej, honorar, imazh /imixh, import, internet, intervistë, izotop, jaht, jard, kameraman, kamping, kampion, kangur, karakter, kartel, kek, kesh, kilovat, klikoj, kliring, klonim, klonoj, kloun, klub, kolaps, kopirajt, kompaktisk, kompjuter, kompjuterizoj, koncern, kongresmen, konsensus, korporatë, kros, kultivar, kurikul, kursor, liberal, marketing, master, maus, menazher, menazhim, menazhoj, mikrobus, miting, mocion, najlon, nokaut, operator, operoj, parking, parlament, partner, pas, (sport.) pasim, (sport.), paund, penallti, penicilinë, piknik, poster, primare, printer, printim, printoj, pulovër, radar, raketë, raund, rekord, rekordmen, ring, risk, rul, rum, rural, sekondare, servis, sesion, shok, (mjek.), shokim, shokoj, skaner, skanoj, snajper, spiker, sterlinë, stok, stop, stres, tablet, tank, tenis, terminal, test, top, trafik (droge), trajner, trajnim, trajnoj, tramvaj, transfer, transparencë, trolejbus, truk, turist, uiski, vagon, vat, vaterpolo, vinç, volejboll, xhaul, xhaz, xhinse, xhungël.*

- Fjalë të huaja jo të pranishme në FGjSh, 2006, por që gjenden në FGjSh, 2020 si: *aifon (angl.), akses, antivirus, apdetoj (angl.), aplikoj, asset, audit, bajpas, bajt, bekgraund, bejsboll, badigard, bold, dekoder, desktop, draft, editor, event, fajl, fastfud, fejsbuk (facebook), flesh, (usb), handicap, huligan, i-meil/imeil, impakt, implementim, informal, keçap, lajv/live, landfil, laptop, liderlidship, listim, listoj, lob, lobing, lobo, menazher, modem, moderator, monitor, monitoroj, monitorim, okej, onlajn, parking, performance, ramstek, relaks, relaksohem, resurs, riskoj, roker, samit, sanduiç, serf, sherif, shou, sponsor, sponsorizoj, sprinter, staf, trend, uotsap (ëhatsapp), videoklip.*

Fjalët e huaja rezultojnë se i përkasin më shumë fushës së shkencës e teknikës, si edhe literaturës shkencore. Siç vërehet nga shembujt, vlen të thuhet se fjalët e huaja të marra në shqyrtim, janë në një numër më të pakët në FGjSh 2006 dhe njohin një rritje në FGjSh 2020. Një ndër arsyt mund të jetë se këto fjalë kanë hyrë në përdorim në gjuhën shqipe bashkë me sendin apo konceptin si në gjuhën e origjinës të tilla si: *antivirus, aplikoj, bold, desktop, decoder, editor, facebook (fejsbuk), modem, online (onlajn), whatsapp (uotsap), lider, lidship, lob, lobo, relaks, relaksohem, sponsor* etj. Po ashtu koha e përfshirjes së tyre në gjuhën në përdorim është më e vonë se sa botimi i FGjSh 2006. Ndonjëherë ndonjë fjalë e huaj nuk bën pjesë në të, por është përfshirë në FGjSh 2020, duke e zgjeruar shkallën e përdorimit të saj.

Nga ana tjetër ka fjalë të huaja që nuk janë në asnjë nga Fjalorët e marrë në shqyrtim si: *online, zoom, fitnes, fans, input, koktej, linçim, mikser, opsion, overdozë, recycle bin (risajkëll bin),*

rafishatë, task forcë, tost etj. Këto fjalë kanë hyrë kohët e fundit në gjuhën shqipe, kur FGjSh 2020 ishte botuar.

Përfundime

Zgjerimi i fjalësit në këta Fjalorë, përfshin fjalë të huazuara në kohë të hershme apo të vonë, sikundër edhe disa fjalë të huaja të cilat përdoren prej folësish të shumtë, duke luajtur kështu një rol të rëndësishëm edhe në zbatimin e terminologjisë së re. Duke qenë se Fjalorët përfshijnë korpusin leksikor të një gjuhe, qoftë zhargonin apo gjuhën shkencore, ata mund të përfshijnë edhe disa fjalë të huaja duke sugjeruar kështu drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e tyre dhe duke dhënë njëherazi burimin nga të cilat kanë ardhur këto fjalë.

Mund të pohojmë se në bazë verifikimit tonë përdorimi i fjalëve të huaja do të jetë në të njëjtën shkallë rritjeje e zgjerimi sikurse edhe dukuria e globalizmit. Gjithaq ato do të jenë pjesë e ligjëritimit të folur dhe të shkruar sa kohë që përdoruesi i gjuhës nuk do të ketë një variant tjetër nga gjuha shqipe për t'i zëvendësuar ato. Përdorimi i tyre do të jetë në një shkallë zbritjeje a zvogëlimi nëse do të ketë një rritje të ndërgjegjes gjuhësore te secili folës dhe i institucioneve të ndryshme.

Si një nevojë e gjuhës për zhvillim shfaqet edhe mënjanimi i “fjalëve të vjetra” dhe zëvendësimi i tyre me “fjalë moderne”. Por ky modernitet nuk mund të paraqitet si një kundërvënie mes së resë dhe të vjetrës, por mes fjalës së panevojshme dhe zëvendësimit të saj me një fjalë e cila mund të ketë strukturë semantike më të gjerë.

Diskutimet, vërejtjet dhe studimet për fjalët e huaja nuk janë të fundme. Gjuhëtarët në bashkëpunim me përfaqësues të politikave qeverisëse mund të arrijnë në përfundime mjaft të frytshme për përfshirjen ose jo të fjalëve të huaja në leksikun e gjuhës shqipe. Nga ana tjetër do të ishte mjaft i volitshëm edhe zëvendësimi apo shqipërimi i tyre.

Gjuha ndjek të njëjtën udhë zhvillimi sikurse edhe shoqëria duke u përmirësuar dhe duke u zhvilluar së bashku me kërkesat e saj. Ajo është mjeti kryesor i cili shërben për të komunikuar, për të shprehur ndjesitë tona, në situata të larme të veprimtarisë njerëzore, njëkohësisht ajo është një ndër tiparet themelore të një kombi, mjetet i shprehjes së identitetit dhe i qytetarisë së individit.

Referencat

- [1]. Kostallari, A. (2016). *Studime në fushën e gjuhës letrare kombëtare Vëll. I, II*. Tiranë. 428 p.
- [2]. Thomai, J. (2017). *Studime për gjuhën shqipe I*. Tiranë. 422 p.
- [3]. Fishman, J.A., Cobarrubias, J. (1983). *Progress in Language Planning: International Perspectives*. University Press, Cambridge. 287 p.
- [4]. Lafe, E. (2011). Rreth fjalëve me burim nga anglishtja në shqipen e sotme. *Guha shqipe* 29/2011, 1, 55-72; *Albanologji 1. Vëllimi II. Punimet nga aktiviteti shkencor Java e Albanologjisë i mbajtur më 25-29 tetor*. Instituti Albanologjik. Prishtinë.
- [5]. Lloshi, Xh. (2022). *E duam shqipen si gjithë Europa*. Shkup.
- [6]. Meier, J. (2000). "The Status of "Foreign Words" in English: The Case of Eight German Words." *American Speech*, vol. 75 no. 2, p. 169-183.
- [7]. Rrokaj, Sh. (2009). *Çështje të gjuhës shqipe 2*. Tiranë.